- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 2. Njoftimin e Kontratës;
 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 8. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për shërbimet. Shërbimetpa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	6	
Artikulli	Përshkrimi i shërbimit	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total për shërbim (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktimi i specifikimeve teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

SPECIFIKIME TEKNIKE

**Mirëmbajtje dhe blerje pjesë ndërrimi për sistemin Help Desk
(prodhuar nga IBM)**

-	Permbajtja	
1	HYRJE	33
2	OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA	33
2.1	Objektivi i Përgjithshëm	33
2.2	Qëllimi	33
2.3	Rezultatet që Duhet të Arrihen nga Kontraktori	34
3	LOGJISTIKA DHE KOHA	34
3.1	Vendndodhja	34
3.2	Data e Fillimit dhe Periudha e Mirembajtjes	34
4	PLANIFIKIMI I BUXHETIT	34
5	KËRKESAT TEKNIKE	34
5.1	Pershkrimi i Përgjithshëm	34
5.2	Kerkesat teknike dhe funksionale te projektit	37
5.3	Kerkesat e Implementimit dhe Upgrade te VMware	38
6	RAPORTIMI	38
7	MIRËMBAJTJA	39
7.1	Sherbime te Mirembajtjes Proaktive	39
7.2	Sherbime Diagnostikimi dhe Riparimi	39
7.3	Suport i Nivelit te Dyte	40
7.4	Menaxhimi i Sherbimit	40
7.5	Nivelet e Sherbimit	40

HYRJE

Vizioni i Albcontrol është të ofrojë shërbime të certifikuara të lundrimit ajror konform kërkesave të Bashkimit Evropian për parrezikshmerinë dhe cilësinë dhe të përmbushin me rigorozitet standardet e Single European Sky. Një nga çelësat e suksesit të punës në Albcontrol është venia e teknologjive në dispozicion të proceseve të përditshme të punës, në të gjitha departamentet e kompanisë. Albcontrol ka adaptuar teknologjinë me të fundit të informacionit duke e kthyer atë në mjet të rëndësishëm në mbështetje të institucionit.

Për të mundësuar lehtësimin e procesit të ofrimit të shërbimit të suportit për të gjithë punonjësit e ndërmarrjes nga departamentet e Teknologjisë së Informacionit apo ato Operacionale, është implementuar sistemi Help Desk në përputhje të plotë me proceset e ITIL dhe ITSM.

Implementimi i sistemit Help Desk është iniciuar si nevojë e Albcontrol për të përmirësuar proceset e brendshme të punës, duke përmirësuar kështu performancën e kompanisë në fushën e Shërbimeve. Detyra e stafit të suportit dhe mbështetjes është të jetë proaktiv dhe të reagojë po ashtu në kohë të shpejtë për zgjidhjen e një problemi të raportuar nga punonjësit. Ky është edhe objekti thelbësor për të cilin është implementuar sistemi Help Desk.

Në vijim të implementimit të sistemit Help Desk dhe nga puna konkrete me këtë sistem, është vënë re, dhe ka lindur nevoja për mirëmbajtje të vazhdueshme si dhe përditesimin e tij, sipas rekomandimeve dhe praktikave me të mira të prodhuesit, për të përmirësuar më tej punën e këtij sistemi në përputhje me pritshmeritë dhe qëllimin për të cilin ai është implementuar.

OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA

Objektivi i Përgjithshëm

Objektivi i këtij projekti është upgrade i platformës së virtualizimit *VMware vSphere Standard 6.7U3* dhe të gjithë komponenteve të saj.

Ky upgrade përkon me versionin më të fundit të certifikuar nga prodhuesi, për infrastrukturën fizike të Help Desk.

Gjithashtu, Albcontrol kërkon që nëpërmjet kësaj kontrate të sigurohet mirëmbajtja dhe suport teknik i sistemit të Helpdesk dhe komponenteve mbështetës për një periudhë 1 vjeçare, sipas grafikut të levrimit të specifikuar në paragrafet e mëposhtme.

Qëllimi

Nëpërmjet kësaj kontrate, Albcontrol synon zgjidhjen e pikave të mëposhtme:

- Implementimin e upgrade të platformës së virtualizimit *VMware vSphere 6.7U3 Standard*
- Rinovimin e licencave dhe suporteve të prodhuesve për çdo komponent të sistemit HelpDesk
- Mirëmbajtjen dhe suportin teknik të sistemit të përditesuar për një periudhë 1 vjeçare sipas afateve të përcaktuara në dokument

Rezultatet që Duhet të Arrihen nga Kontraktori

- Implementimi i upgrade te platformes se virtualizimit VMware vSphere 6.7U3 Standard
- Rinovimin e licencave te prodhueseve per periudhen 1 vjecare
- Ofrimin e sherbimeve te mirembajtjes dhe suportit teknik per sistemin e Helpdesk ne te gjithë komponentet e tij hardware dhe software

LOGJISTIKA DHE KOHA

Vendndodhja

Shërbimet e mirëmbajtjes do të ofrohen onsite në ambientet e Albcontrol si dhe remote sipas nevojës.

Data e Fillimit dhe Periudha e Mirembajtjes

Implementimi i upgrade te platformes se virtualizimit *VMware vSphere 6.7U3 Standard*, si dhe aktivizimi i suporteve te prodhuesit duhet te realizohen brenda 1 muaj nga nenshkrimi i kontrates.

Mirembajtja e sistemit te perditesuar do te ofrohet per nje periudhe 1 vjecare nga nenshkrimi i kontrates, sipas grafikut te ekzekutimit te paraqitur ne paragrafet e meposhtme.

PLANIFIKIMI I BUXHETIT

Nr.	Emërtimi	Sasia
1	Implementimin i upgrade te platformes VMware	1
2	Set Licencash Rinovimi dhe abonime (subscription) 1 vjecar	1
3	Suport dhe mirembajtje 1 vjecare (12 mujore)	12

KËRKESAT TEKNIKE

Pershkrimi i Pergjithshem

Sistemi Help Desk ne Albcontrol eshte implementuar per te perfshire dy divizione, ate Teknik dhe Operacional. Me implementimin e kesaj platforme jane instaluar module te ndryshme sherbimesh, te cilat jane konfiguruar gjate disa fazave. Aktualisht ne sistemin Help Desk jane instaluar modulet e meposhtme te sherbimeve, nje pjese e te cilave jane zhvilluar dhe pershtatur sipak kerkesave dhe nevojave specifike te Albcontrol.

- Administrimi i Incidenteve
- Permbushja e Kerkesave

-
- Administrimi i Problemeve
 - Administrimi i Ndryshimeve
 - Administrimi i konfigurimeve dhe Asetet e sherbimit
 - Administrimi i Niveleve te Sherbimit
 - Administrimi i Katalogut te Sherbimeve
 - Administrimi i Ngjarjeve
 - Administrimi i Leshimit dhe Shperhapjes
 - Administrimi i Disponueshmerise
 - Administrimi Financiar
 - Administrimi i Dijeve

Modulet e konfiguruar dhe pershtatura per Albcontrol trajtojne disa nga proceset me te shpeshta dhe te perditshme te punes ne divizionin Teknik dhe ate Operacional. Per kete qellim jane kryer konfigurime, zhvillime te reja dhe parametrizime te ndryshme te sistemit Help Desk te cilat kane ofruar rezultatet e meposhteme


- Implementimin e procesit te administrimit te Incidenteve sipas praktikave me te mira te ITIL
- Klasifikimin e incidenteve
- Pasjen e databases se incidenteve
- Mundesine e percaktimit te aktoreve te brendshme/jashtem dhe te grupeve te caktuara funksionale me rol te percaktuar ne trajtimin e incidenteve
- Percaktimin e logjikes se ndjekjes se incidenteve sipas llojit dhe rendesise
- Marrjen e njoftimeve per incidentet
- Percaktimin e menyres dhe rruges se shkallezimit te incidenteve
- Percaktimin e rasteve perjashtuese ne procesin e trajtimit te incidenteve
- Percaktimin e statusit te incidenteve gjate ciklit te trajtimit te tyre
- Percaktimin e attributeve te incidenteve gjate ciklit te trajtimit te tyre
- Krijim automatik i incidenteve nga kerkesat per sherbim
- Krijimin e workflows mbeshtetes per trajtimin e incidenteve
- Krijimin e baze klasifikuese per incidentet
- Vendosjen e varesive midis incidenteve dhe SLA-ve
- Jane krijuar KPI-te relevante per procesin e Administrimit te Incidenteve
- Eshte konfiguruar Application Forms per procesin e Administrimit te Incidenteve si dhe grupet e sigurise qe do te trajtojne Incidentet
- Jane krijuar raportet te pershtatura sipas nevojës se Albcontrol ne lidhje me ecurine e incidenteve
- Jane krijuar grupe te reja (Security Groups) INO, ARO, MET, PUBLICATIONS si dhe eshte integruar grupi i inxhinierëve te sistemit (Expert Group) ne procesin e Menaxhimit te Incidenteve (DP, COM, SUR, NAV)
- Eshte krijuar aplikacioni Internal Flights dhe Military Report
- Jane krijuar grupet e sigurise MET Supervisors, ARO Supervisors, INO Supervisors, PUBLICATIONS Supervisors dhe Expert Groups
- Jane krijuar raportimet ditore per SMC, ARO, INO
- Eshte instaluar IBM Cognos Reporting sever
- Eshte implementuar procesi i administrimit te kerkesave (Request fulfillment) sipas praktikave me te mira te ITIL si dhe jane konfiguruar grupet e sigurise qe do te trajtojne kerkesat

- Jane krijuar raporte te pershtatura sipas nevojës se Albcontrol ne lidhje me ecurine e kerkesave
- Eshte krijuar aplikacioni Operational Staff LogBook (menaxhimi i stafit operacional)

Nga pikepamja infrastrukture, sistemi Help Desk mbështetet mbi pajisje IBM, Server dhe Storage te cilat jane virtualizuar per te krijuar rolet e nevojshme per instalimin e sistemit. Ne kuader te permiresimit te sistemit dhe te shtimit te funksionaliteteve, infrastruktura eshte zgjeruar me tej duke perfshire nje ambjent testimi dhe zhvillimi.

Ambjenti Test shërben për nderhyrjet dhe zhvillimet e reja në sistem, pa qenë e nevojshme të preket funksionaliteti i tij në ambjentin Live. Konfigurimet e ambjentit Test janë identike si ato të ambjentit Production, duke shtuar një pajisje të re server të tipit System x 3650 i njëjte me serverin ekzistues të përdorur për ambjentin Production.

Arkitektura e Sistemit Helpdesk jepet logjikisht në skemën më poshtë:



Komponentet hardware dhe software te sistemit te Helpdesk perfshijne si me poshte:

Pajisje

Produkti	SN/SKU	Sasia
IBM SystemX 3650 M5	J305DTA	1
IBM SystemX 3650 M5	06GEXKR	1

Licensa Software

Produkti	Sasia
VMware vSphere 6 Standard for 1 processor	4
Red Hat Enterprise Linux Server, Standard (Physical or Virtual Nodes)	2
Produkti	Sasia
IBM SW, Control Desk Concurrent User	16
IBM SW, Control Desk Everyplace Concurrent User	6
IBM SW, Maximo Asset Management Scheduler Authorized User	1

Te gjitha pajisjet dhe licencat e mesiperme duhet te rinovohen me suport prodhuesit ose me abonimet perkatese per nje periudhe 1 vjecare

Kerkesat teknike dhe funksionale te projektit

Sic u pershkrua dhe me lart, gjate tre fazave te projektit, jane blere pajisje dhe licensa software te ndryshme, per te cilat eshte e nevojshme te kryhet mirembajtje e vazhdueshme proaktive po ashtu edhe te kryhen nderhyrje te nevojshme per te permiresuar apo optimizuar performancen e platformes. Komponentet qe duhet te monitorohen dhe mirembahen do te ndahen ne grupe si vijon:

Hardware

IBM X-Series Servers

Virtualizimi

VMware Vsphere

OS

Redhat Enterprise Linux x64

Aplikime

IBM Control Desk

Kerkesat e Implementimit dhe Upgrade te VMware

Ne kuader te perditesimit te platformes se virtualizimit nga operatori ekonomik kerkohet:

- Perditesim i platformes se virtualizimit VMware vSphere 5.5 ne versionin me te fundit te certifikuar nga prodhuesi per infrastrukturen fizike te HD
- Perditesimi i platformes se virtualizimit duhet te kryhet sipas praktikave me te mira, qe ofron prodhuesi.
- Perditesimi duhet te perfshije te gjitha komponentet e infrastruktures virtuale, si ne nivel hypervisor-i, ashtu edhe ne nivel administrimi.
- Nderfaqja e menaxhimit se platformes virtuale duhet te jete e tipit HTML5.
- OE duhet te siguroje, qe platforma virtuale e implementuar te ofroje minimalisht, te njejtat funksionalitete te platformes virtuale ekzistuese.
- OE duhet te siguroje, qe platforma virtuale e implementuar te kete pershtatshmeri maksimale me serverat virtuale ekzistues te platformes HD.
- Per shkak te kritikalitetit te platformes HD, OE duhet te siguroje, qe gjate implementimit te minimizojte nderprerjen e perdorimit te platformes HD nga perdoruesit e Albcontrol.

RAPORTIMI

Operatori Ekonomik duhet te ofroje sherbime te raportimit dhe dokumentimit per te gjitha incidentet e ndodhura ne platformen e HelpDesk apo sherbimet periodike te kryera. Ne raport duhet te paraqiten edhe veprimet e ndermarra per korrigjimin e problemeve, koha e riparimit dhe detaje te tjera teknike. Ndertimi i modelit te formulareve do te kryhet ne bashkepunim me stafin e Albcontrol.

Raportet e prodhuara nga Operatori Ekonomik do te pergatiten mbi te dhenat e menaxhimit te problemeve dhe duhet te permbajne:

- a. Raportimin mbi implementimin e upgrade te platformes VMware
- b. Raportimin mujor te problemeve te identifikuara
- c. Propozimin e masave organizativo-teknike qe duhen marre me qellim minimizimin e perseritjes se tyre.

Raporti mujor duhet te permbaje informacion mbi gjendjen e infrastruktures fizike dhe virtuale si dhe per problemet, incidentet dhe performancen e sistemit, si edhe propozime dhe rekomandime per mosperseritjen e tyre.

Operatori Ekonomik duhet te kryej monitorimin e vazhdueshem te paltformes Helpdesk dhe duhet te propozojte si me poshte:

- a. Nje plan vjetor te aprovuar per menyren e ofrimit te sherbimeve dhe per kontrollin e logeve te sistemeve qe disponojne te tilla.
- b. Nje plan tremujor per perditesime dhe ndryshime nese do te shfaqet e nevojshme gjate mirembajtjes se sistemeve te platformes Helpdesk.

MIRËMBAJTJA

Operatori ekonomik duhet të ofrojë shërbime mirembajtje për të gjithë komponentet e platformës Helpdesk të përshkruar më sipër duke siguruar edhe mbulimin me suport aktiv nga prodhuesit e pajisjeve hardware dhe software. Suporti duhet të ofrohet për sistemin e Helpdesk të perditesuar, përfshirë edhe proceset e reja të implementuara në këtë projekt.

Sherbimi i ofruar nga Operatori Ekonomik duhet të përfshijë kontrollet periodike të platformës HelpDesk, si dhe përpilimin e raporteve periodike mujore, tremujore dhe vjetore të cilat do të japin një përshkrim të përgjithshëm të performancës dhe gjendjes së platformës.

Sherbime të Mirembajtjes Proaktive

Operatori Ekonomik duhet të kryejë shërbime të mirembajtjes proaktive për të gjitha sistemet e listuara në listen e pajisjeve hardware. Këto shërbime do të kryhen në mënyrë periodike njëherë në dy javë në vendodhjen e Albcontrol, dhe do të përfshijnë:

1. Kontrolli të statusit të komponenteve hardware për pajisjet IBM Servers x3650
2. Kontrolli të infrastrukurës virtuale VMWare Vsphere
3. Kontrolli të sistemit të backup të makinave virtuale
4. Kontrolli periodik i Sistemeve të Operimit dhe Aplikimeve të IBM.
5. Kontrolli të statusit të komponenteve software të IBM Control Desk: DB2 database, Websphere Application Server, HTTP Server, WebGui, LDAP Directory Server
6. Kontrolli të statusit të Base Services të IBM Control Desk application

Sherbime Diagnostikimi dhe Riparimi

Përveç mirembajtjes proaktive, Operatori Ekonomik duhet të ofrojë Shërbime Riparimi dhe Diagnostikimi në vendodhje për çdo problem të sinjalizuar nga stafi i Albcontrol ose të vërejtura gjatë kontrolleve periodike të kryera. Shërbimet e diagnostikimit dhe riparimit duhet të ofrohen me disponueshmëri 24x7. Operatori Ekonomik duhet të ofrojë shërbime mirembajtjeje për korrigjim gabimesh dhe modifikime eventuale, të cilat përfshijnë:

1) Shërbime Mirembajtje për pajisjet Hardware

- Diagnostikim të të gjitha problemeve të lidhura me hardware për serverat IBM, storage IBM dhe IBM SAN Switch-e
- Ndërrim të pjesëve Hardware për IBM Servers, IBM Storage, IBM SAN Switches.
- Trajtim me termat e garancisë nga IBM.

2) Shërbime Mirembajtje të lidhura me infrastrukurën virtuale VMWare

- Troubleshoot të problemeve me infrastrukurën virtuale VMWare Vcenter Cluster, Makinave Virtuale.
- Eskalim të problemeve me suport nga vendori VMWare.
- Rikonfigurim të makinave virtuale në rast se kërkohej nga AlbControl

-
- Kryerjen e VM restore ne rast te problemeve madhore te makinave virtuale qe kerkojne restore nga backup

3) Sherbimet e mirembajtjes, ne lidhje me aplikimin:

- Troubleshoot te problemeve te lidhura me OS RHEL me eskalim me supportin e vendorit.
- Troubleshoot te problemeve me databazat DB2 ose Web Sphere Application server
- Krijim/modifikim te objekteve dhe attributeve nerpermjet aplikacionit Database Configuration
- Customizim te aplikacioneve aktuale (shtim domain, nderlidhja me atributet, ndryshim i te drejtave te aksesit te perdoruesve ne nderfaqe web)
- Krijim/modifikim te StartCenter per grupet e ndryshme te perdoruesve
- Krijim/aktivizim i escalimeve per monitorimin e rekordeve qe mund te veprojne ose dergojne njoftime
- Krijim i klasifikimeve te reja na varesi te kerkesave te Albcontrol
- Shtim/Modifikim i listes se pajisjeve te integruara ne sistemin e service desk
- Modifikim i rekordeve te SLA sipas Klasifikimeve/pajisjeve

Suport i Nivelit te Dyte

Operatori ekonomik duhet te ofroje sherbime te suportit te Nivelit te Dyte, duke eskaluar ne rastet kur nevojitet problemin tek prodhuesit perkates. Operatori Ekonomik duhet te siguroje qe sherbimet e prodhueseve do te jene aktive pergjate gjithe periudhes se kohezgjatjes se kontrates si dhe do te pergjigjet per menaxhimin, ndjekjen dhe riparimin e problemit brenda kohes se percaktuar.

Menaxhimi i Sherbimit

Operatori Ekonomik duhet te ofroje takime periodike duke organizuar, administruar dhe menaxhuar takimin dhe follow-up. Per kete qellim, Operatori Ekonomik duhet te vendose ne dispozicion nje skuader te dedikuar e cila do te jete pjesemarrese ne prodhimin e planit e Komunikimit dhe te percaktoje:

- daten, kohen, vendndodhjen e takimeve
- scope-n e shqyrtimit, cilat sherbime do merren ne shqyrtim

Takimet duhet te kene qellim trajtimin e ceshtjeve te meposhtme dhe jo vetem:

- ☐ Sherbimet qe ne menyre te konsiderueshme kane kerkuar me shume perpjekje ose investim per t'u permbushur nga sa ishte planifikuar.
- ☐ Sherbimet ku ka patur ndryshime te rendesishme ne mjedisin e punes
- ☐ Sherbimet me ndikim te rendesishem ne arritjen e nivelit te sherbimit, ne biznes, apo per klientet dhe perdoruesit
- ☐ Shqyrtimi nga "mesimet e nxjerra", minuta, dhe planet e veprimit nga shqyrtime te meparshme SLA te zgjidhjes se sherbimit ose zgjidhje te ngjashme te sherbimit, te vemendjes se veçante.

Nivelet e Sherbimit

Kompania duhet te ofroje mbulim te sherbimit 24x7 me kohe pergjigje sipas tabelës se mëposhtme:

Kategoria 1 (Kritik/ I	Kategoria 2 (I Mesem)	Kategoria 3 (I Ulët)
Nderprerja e komunikimeve te te dhenave prek mbi 70 % te sistemeve ne suport	Nderprerja e komunikimeve te te dhenave prek mbi 15 % sisteme ne suport	Nderprerja e komunikimeve te te dhenave prek nen 15 % te sherbimeve ne suport
Numri i perdoruesve te ndikuar		

Mos funksionimi ndikon nje numer shume te madh te perdoruesve	Mos funksionimi ndikon nje numer te vogel te perdoruesve	Mos funksionimi ndikon pjeserisht vetem perdoruesit e nje departamenti/niesie
Pezullimi i punes		
Mos funksionimi pengon perdoruesit <u>te realizojne pjesen me te madhe te punes se tyre.</u>	Mos funksionimi pengon perdoruesit <u>te realizojne pjese te punes se tyre qe kane lidhje kryesisht me institucione te tjera</u>	Mos funksionimi pengon perdoruesit <u>te realizojne disa pjese te vogla te punes se tyre.</u>
Zgjidhje alternative e perkohshme		
<u>Nuk ka nje menyre alternative</u> te perkohshme dhe te pranueshme per zgjidhjen e	<u>Ka pjeserisht nje menyre alternative</u> te perkohshme dhe te pranueshme per zgjidhjen e problemit.	<u>Ka nje menyre alternative</u> te perkohshme dhe te pranueshme per zgjidhjen e problemit.
Koha e pergjigjes		
☐ Brenda 30 minutash ☐ Ne vend brenda 3 oreve	☐ Brenda 4 ore ☐ Ne vend brenda 6 oreve	☐ Brenda Dites Tjeter te Punes ☐ Ne vend Brenda 2 diteve

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: “Shpenzime mirëmbajtje dhe blerje pjesë ndërrimi për sistemin Help Desk-IBM”,

Afatet e ekzekutimit: 12 muaj nga nënshkrimi i kontratës.

Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: “Shpenzime mirëmbajtje dhe blerje pjesë ndërrimi për sistemin Help Desk-IBM”,

Detyrat: Sipas shtojces se specifikimeve teknike

Shpërndarja: Sipas shtojces se specifikimeve teknike

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Albcontrol sha

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënua për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënua ose nuk ka qenë i dënua nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënua me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërket për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

➤ Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore, ku xhiroja mesatare vjetore për 3 vitet e fundit financiare (2018,2019,2020), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e **fondit limit** në procedurën e prokurimit.

2.2.2 Bilancet e viteve 2018, 2019 dhe 2020 miratuar nga organet perkatese shteterore. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit

Argumentimi: Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë kontrata ku të kete realizuar shërbime të ngjashme, në një vlerë sa 40 % e fondit limit që prokurohet, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe faturave tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara dhe të jenë të deklaruara në organet tatimore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41/3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën që AK kërkon të realizojë, prandaj është kërkuar përvojë e ngjashme të jenë në vlerën jo më e madhe se 40% të

vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqese certifikatat që vertetojnë perputhshmerine me standardet:

- **ISO 9001:2015**, Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë ose ekuivalent e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve që prokurohen dhe të jetë brenda kohës së vlefshmerise.
- **ISO 27001-2013**, Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë Informatike ose ekuivalent e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve që prokurohen dhe të jetë brenda kohës së vlefshmerise.
- **ISO 20000-1:2011**, Sistemi për Menaxhimin e Shërbimeve ose ekuivalent e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve që prokurohen dhe të jetë brenda kohës së vlefshmerise.

Certifikatat duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH, Ose ekuivalente me to.

Argumentim: Ky kriter u vendosën në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Sqarojmë se Albcontrol sha, operon në një fushë që është shumë specifike “Navigimi Ajror”, sipas rregullores Europiane 1035/2011 dhe të audituar nga ana e Agjensisë Europiane të Sigurisë së aviacionit (EASA) çdo dy vjet, ndërkohe sistemet me të cilët operon duhet të jenë komptibël me kërkesat e rregullatorëve ndërkombëtare të Aviacionit Civil sipas Rregullores së Komisionit Europian EC 552/2004 si dhe kërkesave të tjera që kanë të bëjnë me sigurinë dhe përputhshmërinë me rregulloret si dhe me sistemet e tjera që janë operative. Albcontrol është gjithashtu i certifikuar, për shkak të natyrës së aktivitetit me ISO 9001:2015, ISO 14001:2015, ISO 45001:2018, ISO 27001:2013, ISO 20000-1:2018, SES (Reg 2017/373).

Sistemi i menaxhimit të cilësisë siguron që operatori zotëron aftësitë për të ofruar shërbime që plotësojnë pritshmëritë kërkesat dhe specifikimet e klientit përmes aplikimit efektiv dhe cilesor të tij.

Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit siguron që operatori ekonomik aplikon, mirëmban dhe përmirëson në mënyrë të vazhdueshme një përfaqëse sistematike në menaxhimin e informacionit sensitiv me fokus tek siguria.

Menaxhimi i shërbimit IT siguron që operatori ekonomik ka të implementuar një sistem ofrimi të shërbimit përmes të cilit efektivisht planifikon, implementon, operon, monitoron, kontrollon dhe mirëmban portofolin e shërbimeve dhe cilësinë e tyre.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të paraqese autorizim prodhuesi ose distributores të autorizuar, apo të tjere lejuar/certifikuar/autorizuar nga prodhuesi si dhe marrëveshjen e bashkëpunimit me prodhuesin e Sistemit Helpdesk (IBM), ku të evidentohet statusi i partneritetit si Solution Provider. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77/2 të LPP: Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

Sherbimet e suportit për sistemin Helpdesk përfshijnë dhe shërbime të mirembajtjes të teknologjise standarde IBM në të cilën është implementuar sistemi Helpdesk, rrjedhimisht është e domosdoshme që operatori fitues të jetë i autorizuar për lehtësimin e kësaj suporti nga prodhuesi IBM apo nga të tjerë të autorizuar nga IBM për këtë në Shqipëri. Kjo siguron që shërbimet e ofruara janë genuine (që rrjedhin nga IBM) dhe minimizon riskun për mos respektimin e kushteve të kërkuara mbi kohën dhe cilësinë e dënjës së shërbimit për teknologjinë standarde në fjalë. Në të njëjtën kohë duke patur parasysh që zgjidhja është specifike prodhuesi IBM ka një rrjet kompanish të quajtura Solution Provider me anë të të cilave implementon dhe suporton zgjidhjet e tij. Për këtë kërkohej provë partneriteti me këtë status.

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të ketë status partneriteti me prodhuesin VMware të pakten të nivelit Advanced ose ekuivalent, me qëllim ofrimin e shërbimeve të mirembajtjes për infrastrukturën virtuale VMware, ku mbështetet sistemi Helpdesk.

Argumentim: Shërbimet e suportit dhe të upgrade të platformës VMware janë shërbime që do të kryhen e levrohen në teknologji standarde të përcaktuara, të implementuara me pare, rrjedhimisht është e domosdoshme që operatori fitues të ketë një status të caktuar partneriteti me këtë Prodhues. Statusi i Partneritetit Advanced tregon që OE ka provuar tek prodhuesi VMware aftësitë e tij në lidhjen e teknologjive perkatese. Kjo siguron që shërbimet e ofruara janë të një kualiteti të lartë (që provohen nga Prodhuesi) dhe minimizon riskun për mos respektimin e kushteve të kërkuara mbi kohën dhe cilësinë e dënjës së shërbimit për teknologjinë standarde në fjalë.

2.3.6. Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë të gjithë stafin dhe personelin tekniko-profesional, i cili do të angazhohet në shërbimet e kërkuara. Në përberje të stafit Operatori Ekonomik duhet të ketë minimalisht stafin e mëposhtem.

a) Të pakte 2 (dy) specialiste të certifikuar nga prodhuesi për sistemet IBM Storwize Storage ose ekuivalent.

b) Të pakte 2 (dy) specialiste të certifikuar nga prodhuesi për serverat IBM/Lenovo ose ekuivalent ku mbështetet sistemi Helpdesk

Argumentim: Duke qenë që sistemi Helpdesk është implementuar në Hardware – Serverat IBM/ Lenovo dhe storage IBM në mënyrë që të sigurohet dhe me qenë se kërkohej suporti teknologjik i këtyre pajisjeve atëherë për të siguruar mbarevajtjen e kontratës kërkohej që për secilin teknologji të jenë të pakten 2 persona të kualifikuar nga prodhuesi për teknologjinë perkatese.

c) Të pakten 1 (një) specialist të certifikuar nga prodhuesi IBM si IBM Certified Associate për sistemin Smart Cloud Control Desk ose ekuivalent

Argumentim: Duke qenë që sistemi Helpdesk bazohet në zgjidhjen teknologjike të prodhuesit IBM Smart Cloud Control Desk atëherë që të sigurohet suporti i kësaj zgjidhjeje Operatori Ekonomik duhet të provojë që ka personelin e aftë që e njeh këtë zgjidhje. Gjykohej që për të siguruar mbarevajtjen e kontratës të kërkohej që Operatori Ekonomik të ketë në stafin e tij të pakten 1 person të kualifikuar nga prodhuesi për teknologjinë ku bazohet kjo zgjidhje. Certified Associate është certifikata e prodhuesit IBM që vërteton këtë.

d) Të pakten 2 (dy) specialiste të certifikuar nga prodhuesi IBM Certified Database Associate - DB2 ose ekuivalent për bazën e të dhënave mbi të cilën mbështetet sistemi Helpdesk.

Argumentim: Duke qenë që sistemi Helpdesk është implementuar në një platformë të ngritur mbi Data Bazën e teknologjise DB2 të IBM atëherë që të sigurohet suporti i plotë kësaj zgjidhjeje Operatori Ekonomik duhet të provojë që ka personelin e aftë që e njeh këtë

Data Baze. Gjykohet që për të siguruar mbarevajtjen e kontratës të kërkohej që Operatori Ekonomik të ketë në stafin e tij të pakten 2 persona të kualifikuar nga prodhuesi për teknologjinë e Bazës së të Dhenave ku është implementuar kjo zgjidhje. Certified Database Associate - DB2 është certifikata e prodhuesit IBM që verteton këtë.

e) Të pakten 2 (dy) specialiste të certifikuar në teknologjinë e virtualizimit VMware të nivelit profesional ose ekuivalent, me qëllim ofrimit të shërbimeve të mirëmbajtjes për infrastrukturën VMware ku mbështetet sistemi Helpdesk.

